



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 105/1 Prot.

Tiranë, më 26.01 2026

VENDIM

Nr. 15, datë 15.01.2026

**“PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT VASJANA POSTOL NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar (në mungesë)
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 15.01.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për transferimin e prokurorit Vasjana Postol në Prokurorinë pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet procedurës së
lëvizjes paralele”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 105 prot., datë 09.01.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, *“Për shpalljen e 23 (njëzet e tre) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe shpalljen e 3 (tre) vendeve vakante nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”*, Këshilli shpalli 23 (njëzet e tre) vendeve vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër dhe Tiranë. Njëri ndër vendet e shpallura është pozicioni vakant nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet etj, janë njoftuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit në datë 20.02.2025. Pas përfundimit të afatit të aplikimit në datë 06.03.2025, me Vendimin nr. 55, datë 27.03.2025, *“Për miratimin e listës së prokurorëve që kanë kandiduar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli miratoi listën e prokurorëve që kandiduan nëpërmjet lëvizjes paralele për vendet vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025.
4. Me Vendimin nr. 56, datë 27.03.2025, *“Për caktimin e relatorit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për kandidatët që kanë kandiduar për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli caktoi nëpërmjet procedurës së hedhjes së shortit, relatorët për secilin pozicion të shpallur sipas vendimit nr. 27, datë 14.02.2025. Për pozicionin vakant nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u zgjodh relator z. Sokol Stojani.
5. Në zbatim të neneve 11 pika 1 dhe , si dhe nenit 18, pika 1 të Vendimit nr. 261, datë 17.11.2020, *“Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, e ndryshuar (në vijim *Rregullorja*), Relatori ka njoftuar kandidatët për këtë pozicion, në rrugë elektronike (me e-mail), në datë 31.03.2025 dhe 30.04.2025, për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
6. Meqenëse pas kalimit të këtij afati nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e relatorit, është filluar puna për verifikimin e plotësimit të kriterëve të vlerësimit nga ana e kandidatëve, bazuar në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar (në vijim *Ligji për Statusin*), si dhe nenet 8, 15, 21 të Rregullores.

7. Me Vendimin nr. 91, datë 14.05.2025, *“Për verifikimin e kushteve ligjore të kandidatëve në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për vendet vakante në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm shpallur me vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*, Këshilli miratoi listën emërore të kandidatëve që kanë aplikuar në këtë procedurë administrative. Në po të njëjtin vendim, Këshilli ndaloj vijimin e procedurës administrative për aplikantët Greta Dreni dhe Arbër Delilaj.

8. Me Vendimin nr. 205, datë 25.07.2025, *“Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli miratoi renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin nr. 4, në zyrën e Prokurorisë Elbasan, si vijon:

- i.Xhoana Mehmetaj
- ii.Lorena Salillari
- iii.Vasjana Postol
- iv.Oliana Gjergjeji
- v.Albulena Kuliçi
- vi.Ervis Alliaj
- vii.Drini Zeqo
- viii.Silvana Belishta
- ix.Alisa Spahja

9. Vendimi i është njoftuar kandidatëve në datë 01.08.2025, dhe nga zyra e Protokollit pranë Këshillit nuk është administruar në institucion asnjë ankim gjyqësor në kuptim të nenit 22, pika 3, të Rregullores.

10. Kandidatja e renditur e para, znj. Xhoana Mehmetaj ka paraqitur dorëheqjen nga ky pozicion me Kërkesën administruar me nr. 645/2 prot., datë 07.03.2025.

11. Kandidatja e renditur në vend të dytë, znj. Lorena Salillari, me Vendimin nr. 203, datë 25.07.2025, *“Për transferimin e prokurorit Lorena Salillari në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, të Këshillit është transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, në pozicionin nr. 1, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit, në zyrën e Prokurorisë Elbasan.

12. Ndërkohë, kandidatja Vasjana Postol me Kërkesën e regjistruar me nr. 633/1 prot., dt. 04.12.2025, ka paraqitur heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin vakant nr. 5, në zyrën e Prokurorisë Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, pozicioni i cili ka qënë preferencë e parë e kandidatës.

13. Në këto kushte, nisur nga renditja e miratuar sipas Vendimit nr. 205, datë 25.07.2025, të cituar më sipër, përmes Relacionit të mësipërm, Komisioni i propozoi Këshillit

transferimin e znj. Vasjana Postol në pozicionin vakant nr. 4, në zyrën e Prokurorisë Elbasan, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, bazuar në nenin 45, pika 1 të Rregullores, e cila parashikon:

“1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.”

14. Prokurorja Vasjana Postol është caktuar në detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me Vendimin nr. 207, datë 27.07.2022, *“Për caktim në detyrën e prokurorit”*, të Këshillit. Nga dosja personale rezulton se, deri në datë 14.02.2025 ka rreth 2.5 vite muaj vjetërsi pune si magjistrat, si përvojë profesionale specifike në atë shkallë për të cilën ka kandiduar.

15. Përsa më sipër vlerësohet e përfunduar procedura administrative për plotësimin e pozicionit vakant nr. 4, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele të prokurorit Vasjana Postol në këtë zyrë prokurorie.

16. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë në kushtet kur, Komisioni propozoi kalimin gradual në detyrë në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, konkretisht pikës 3, të nenit 104, *“Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ”* të tij, ku përcaktohet se:

“1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose;

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”

17. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të Prokurorisë, do të krijohen në një moment të dytë, konkretisht në datë 26.01.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 45, të Vendimit nr. 261, datë 17.11.2020, “Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e prokurorit Vasjana Postol në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet lëvizjes paralele.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan duke filluar nga data 26.01.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe prokurori Vasjana Postol.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 15.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirëla Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla